

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Ferit Osmani, kryetar i kolegjit, gjyqtarët Hashim Çollaku dhe Shqipe Qerimi, anëtarë, me zyrtarin ligjor Visar Gashi, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të E.B., me vendbanim në Prishtinë, ..., për shkak të veprës penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par 6 lidhur me par 1 të KPK, duke vendosur sipas ankesës së të akuzuarit, të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, P.nr.2695/2014, të dt.28.03.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur me 31.05.2018, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa e të E.B., kurse aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, P.nr.2695/2014, të dt.28.03.2018, **vërtetohet**.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e ankimuar të Gjykatës Themelore në Prishtinë, P.nr.2695/2014, të dt.28.03.2018, është shpallur fajtor i akuzuari E.B., për shkak të veprës penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par 6 lidhur me par 1 të KPK, dhe i është shqiptuar dënimi me gjobë në shumën prej 300 (treqind) €, të cilin dënim është obliguar që ta paguajë në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në të kundërtën dënimi i shqiptuar me gjobë, do të zëvendësohet në dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, duke llogaritur për çdo ditë të kaluar në burg nga 20 (njëzetë) €.

Është obliguar i akuzuari që të paguajë shpenzimet e procedurës penale, sado që të jenë ato sipas llogarisë së bërë në arkë të gjykatës, si dhe paushallin gjyqësor në shumën prej 20 (njëzetë) €, të gjitha këto në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Të dëmtuarit, A. dhe Q.K., për realizimin e kërkesës pasurore-juridike, janë udhëzuar në kontestin e rregullt juridiko-civil.

Kundër këtij aktgjykimi, në afat ligjor ka ushtruar ankesë i akuzuari E.B., për shkak të vendimit lidhur me sanksionin penal, duke propozuar që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet, dhe të njëjtit ti shqiptohet një dënim më i butë.

Prokuroria e Apelit në Prishtinë, me shkresën PPA/II.nr.532/2018, të datës 18.05.2018, duke u sqaruar përkitazi me ankesën e të E.B., ka propozuar që e njëjta të refuzohet si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Gjykata e Apelit në kuptim të nenit 394 të KPPK, duke vlerësuar pretendimet ankimore nga ankesa e ushtruar, propozimit me shkrim të Prokurorisë së Apelit në Prishtinë, si dhe shkresave tjera të lëndës ka gjetur se:

Ankesa e të E.B., nuk është e bazuar.

Meqenëse aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë nuk është ankimuar për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, gjykata duke vepruar në pajtim me nenin 394 të KPPK, e shqyrtoj aktgjykimin e ankimuar nëse i njëjti është marrë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, dhe gjeti se i njëjti nuk përmban shkelje të dispozitave të procedurës penale, si dhe shkelje të ligjit penal në dëm të akuzuarit, të cilat do të kushtëzonin anulimin e tij, për të cilat kjo gjykatë kujdeset kryesisht sipas detyrës zyrtare.

Sipas ankesës së të akuzuarit, aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, është ankimuar për shkak të vendimit lidhur me sanksionin penal, duke theksuar se dënimi i shqiptuar nga ana e gjykatës së shkallës së parë për të akuzuarin është shumë i ashpër dhe nuk është adekuat me peshën e veprës penale të kryer, përgjegjësinë penale të akuzuarit, rrezikshmërinë shoqërore të veprës penale, si dhe mënyrën e kryerjes së saj, ngase i akuzuari në shqyrtimin fillestar e ka pranuar fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë, dhe është penduar thellësisht për kryerjen e të njëjtës. Gjithashtu, gjykata e shkallës së parë me rastin e marrjes së vendimit për dënimin, caktimit të llojit dhe lartësisë së tij, nuk ka vlerësuar drejtë rregullat e përgjithshme për matjen e dënimit, sepse në kuptim të nenit 73 par 2 të KPPK, dënimi i shqiptuar duhet të jetë në proporcion me peshën e veprës penale të kryer, si dhe sjelljen dhe rrethanat e kryerësit, andaj, konsiderojmë se dënimi i shqiptuar të akuzuarit është shumë i ashpër.

Kolegji i Gjykatës së Apelit, ka vlerësuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, ankesën e ushtruar, si dhe shkresat e tjera të lëndës, dhe ka ardhur në përfundim, se nga ana e gjykatës së shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të plotë është vërtetuar gjendja faktike, se aktgjykimi i ankimuar nuk përfshihet me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale, si dhe shkeljet e ligjit penal, andaj, duke vlerësuar aktgjykimin e ankimuar, kolegji vie në përfundim se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë ka vlerësuar rrethanat të cilat ndikojnë me rastin e marrjes së vendimit për dënimin, caktimit të llojit dhe lartësisë së tij, në kuptim të nenit 73 të KPK, sikurse janë rrethanat lehtësuese, se i akuzuari në shqyrtimin fillestar e ka pranuar fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë, se ka patur qëndrim korrekt në gjykatë, ndërsa si rrethana rënduese nuk gjeti, andaj, në prani të këtyre rrethanave, e duke mos gjetur ndonjë rrethanë posaçërisht lehtësuese, sikurse pretendon i akuzuari në ankesën e ushtruar, kolegji i kësaj gjykate, është i bindur se me dënimin e shqiptuar nga ana e gjykatës së shkallës së parë, do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij i paraparë me nenin 41 të KPK, që të parandaloj kryerësin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëj rehabilitimin e tij, të parandaloj personat e tjerë nga kryerja e veprave penale, të bëj kompensimin e viktimave ose të komunitetit për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga vepra penale, dhe të shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Nga sa u tha më lartë e në pajtim me dispozitën e nenit 401 të KPPK, u vendos sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PA1. nr.525/2018, të datës 31.05.2018

Zyrtari Ligjor
Visar Gashi

Anëtarët e kolegjit
Hashim Çollaku

Kryetari i kolegjit
Ferit Osmani

Shqipe Qerimi